

BULETINI I  
INSTITUTIT SHENDETIT  
PUBLIK

---

Institute of Public  
Health Bulletin

3 - 2006

Bordi i publikimit

Eduard KAKARRIQI

Drejtor

Silva BINO

Shefe e Dep.te semundjeve infektive

Arben LUZATI

Shef i Dep.

Besa BUDO

Shefe e Dep.t te botimeve

Alban YLLI

Shef i Dep.te menaxhimit

Gledjona Tola

Koordinator e buletinit

Design. G.MUSA

Adresa : Instituti i Shëndetit Publik

Rr. Aleksandër Moisiu Nr. 80

Tiranë ALBANIA

Tel / Fax. 00355 43 700 58

Email: [iphealth @ sanx.net](mailto:iphealth@sanx.net)

Publikimi i Buletinit të I.SH.P.

u sponsorizua nga :

Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik

## PERMBAJTJA 3 / 2006

- 1. Ndikimi i temperaturës së ruajtjes në magazinim dhe tregtim si faktor kryesor në sigurinë e qumështit të pasterizuar.**

*Dr. Lindita Molla, Dr. Donika Bocari, Nesib Bejleri, Yllka Xhumari*

- 2. Monitorimi i zëhurmave urbane në 8 qytete për vitin 2006**

*Fiz. Arti Cicolli*

- 3. Mbeturinat dhe impakti në shëndet dhe mjedis**

*Dr. Arben Luçati, Ing. Sanitar Bujar Reme*

- 4. Matjet analitike të ndricimit në shkollat e arsimit 9 – vjeçar dhe impakti në shëndet tek grup – moshat 6 – 9 vjeç.**

*Arta AGO, Arti CICOLLI, Dr. Elizana PETRELA, Dr. Adrian HOXHA,  
Besnik SERJANI*

- 5. Situata higjieno-sanitare e ujit të pijshëm në zonat urbane të vendit për periudhën Janar – Dhjetor 2006**

*Valbona Bara, Zaira Poga, Arben Luçati, Bujar Reme, Luljeta Leno, Alba Merdani,  
Ramazan Bukli, Kol Geraj, Alfred Shehi*

- 6. Monitorimi i cilësive së ajrit në Shqipëri gjatë vitit 2006**

*Agron DELIU*

## NDIKIMI I TEMPERATURËS SË RUAJTJES NË MAGAZINIM DHE TREGTIM SI FAKTOR KRYESOR NË SIGURINË E QUMËSHTIT TË PASTERIZUAR.

Dr. Lindita Molla, Dr. Donika Bocari, Nesib Bejleri, Yllka Xhumar

### Hyrje

Në vitet e fundit numri i sëmundjeve me origjinë nga ushqimet shkaktuar nga mikroorganizmat ka ardhur duke u rritur në mënyrë të vazhdueshme. Nje rritje reale e këtyre sëmundjeve mund të shkaktohet nga manipulimet në procesin e prodhimit, koha e gjatë e transportit dhe shpërndarjes, rritja e kohës gjatë konservimit si dhe ndryshimet e sjelljes dhe të konsumimit të produkteve (1).

Rëndësi të veçantë për parandalimin e këtyre sëmundjeve marrin dhe faktorët favorizues të ndryshimit të përbërjes dhe uljes së sigurisë së ushqimeve. Faktorët kryesorë që influencojnë në sigurinë e ushqimeve janë disa, nga të cilët mund

të përmendim përbërjen e lartë proteinike të produkteve, vlerën e pH,  $a_w$  (aktiviteti ujit), temperaturën dhe kohën e konservimit dhe ruajtjes së produkteve (2).

Nisur nga sa u përmend më mësipër kryem një sondash gjatë sezonit të verës (qershor – korrik) me produktin qumësht i pasterizuar për të parë se si ndikon faktori temperaturë në sigurinë e këtij produkti.

### Qëllimi

Vlerësimi i sigurisë së përdorimit të produkteve me origjinë shtazore (qumësht) nën ndikimin e faktorëve të jashtëm (temperaturës).

### Objektivi

Inspektimi në prodhim dhe në tregtim

Analizimi i treguesve mikrobiologjikë

### Materiali dhe metoda

Sondazhi është kryer për një periudhë 2 mujore qershor- korrik 2006, dhe është bazuar në marrjen e mostrave të qumështit dhe kosit në disa fabrika të përpunimit të qumështit dhe në tregtim.

Në studim janë përfshirë 10 fabrika të qyteteve Lushnje, Kavaje dhe Tiranë si dhe vendet e tregtimit (dyqane), të cilët tregtojnë të njëjtat produkte të prodhuara në fabrikat e lartë përmendura. Mostrat e produkteve janë marrë në mënyrë rastësore si në fabrikë dhe në vendet e tregtimit.

Janë analizuar 90 mostra produktesh nga të cilat janë marrë 45 mostra në fabrikë dhe 45 në vendet e tregtimit. Në vendmarrjen e mostrës

është kryer dhe matja e temperaturës për çdo mostër produkti.

Mostrat e marra janë sjelle në laboratorin mikrobiologjik të ISHP brenda 2 orësh nga momenti i marrjes dhe janë transportuar me kuti frigoriferike sipas rregullit të transportimit të produkteve ushqimore (3).

Përpunimi i të dhënave është bërë me programin SPSS (4).

**Sondazhi është bazuar në:**

**1. Inspektimi higjiemo – sanitar dhe marrje mostrash** në fabrikat e prodhimit

- personelin në ndërmarrjet prodhuese
- mjediset e punës
- mjetet e punës në prodhim(5)

- marrje e 45 mostrave të qumështit të pasterizuar si dhe në pikat e tregtimit janë marrë 45 mostra të qumështit të pasterizuar për analizën e treguesve baktoreologjikë.

**2. Analiza e treguesve mikrobiologjike** për 90 mostrat e qumështit, ku përfshihen treguesit e mëposhtëm:

- mikroflora aerobe mezofile (MAM)
- Coliforme total
- E.coli
- Salmonella
- Shigella
- S.aureus
- Myqe (5)

Analizat për treguesit mikrobiologjike janë kryer sipas metodikës së paraqitur në pasqyrën 1

Mikrorganizmi	Pasurimi	Izolimi	Identifikimi
MAM		PCA 30C <sup>0</sup> 72 h	
Coliforme		BGB 37C <sup>0</sup> 24 h	
E.Coli	BGB 37C <sup>0</sup> 48h	BGB 44C <sup>0</sup> 24 h	Indol
St.aureus		Ag.gjak 37C <sup>0</sup> 48 h	Koagulaze
Salmonella	BPW 37C <sup>0</sup> 24 h		
	Selenit 37C <sup>0</sup> 24 h	DC 37C <sup>0</sup> 24 h	Kliger
	Rapp.Vassil.34C <sup>0</sup> 24h		
Myqe		PYA:Capek 30C <sup>0</sup> 5 dite	Mikrosk.

Inspektimi dhe marrja e mostrave të produkteve më bazë qumështi janë kryer sipas Rregullores Higjiemo – Sanitare Nr.5 datë 25 / 6 / 1993 (3).

Vlerësimi i rezultateve është bazuar në normativat mikrobiologjike të qumështit e nënprodukteve të tij të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë 1985 (6), paraqitura në pasqyrën 2.

*Pasqyra 2. Norminat mikrobiologjike të qumështit*

*Pasqyra 4. Paraqitja e mostrave të marra në tregun e shijes grupuar sipas temperaturës*

Nr	Treguesit	Norma
1	MAM	>100 000 / ml
2	Coliforme	> 50 / ml
3	E.coli	> 10 / ml
4	S.aureus	mungon / ml
5	Salmonella	mungon / 25 ml
6	Shigela	mungon / ml

### Rezultatet dhe Diskutimi

Nga inspektimi higjieno - sanitar në fabrikat e marra në sondazh rezulton se :  
Respektoheshin rregullat higjieno – sanitare të prodhimit të produktit të pasterizuar, e cila evidentohet dhe nga treguesit analitik mikrobiologjikë.

Më poshtë po japim rezultatet e fituara nga analizat mikrobiologjike për mostrat e marra në fabrikë dhe në treg, krahasuar me temperaturën e ruajtjes.

*Pasqyra3. Paraqitja e mostrave të marra në fabrika grupuar sipas temperaturës*

<i>Nr. mostrave</i>	<i>Temperatura</i>	<i>Ngarkesa mikrobike</i>
3	+ 8 C <sup>0</sup>	Positive*
42	+ 4 C <sup>0</sup>	negative

**Totali = 45 mostra**

*Pasqyra 4. Paraqitja e mostrave të marra në tregun e shijes grupuar sipas temperaturës*

<i>Nr. mostrave</i>	<i>Temperatura</i>	<i>Ngarkesa mikrobike</i>
14	+ 4 C <sup>0</sup>	negative
6	+ 8 C <sup>0</sup>	positive
4	+ 9 C <sup>0</sup>	pozitive
8	+ 10 C <sup>0</sup>	pozitive
6	+ 11 C <sup>0</sup>	pozitive
2	+ 12 C <sup>0</sup>	pozitive
2	+ 13 C <sup>0</sup>	pozitive
3	+ 15 C <sup>0</sup>	pozitive

**Totali = 45 mostra**

Shënim: \* ngarkesë mikrobike pozitive konsiderohet ngarkesa mbi normat e lejuara për produktin në fjalë, në rastin tonë për qumështin e pasterizuar.

Nga analiza e rezultateve analitike del se nga grupi i mostrave të marra në fabrikë rreth 6,6 % e tyre kanë ngarkesë mbi normat për MAM që është brenda normave të lejuara të prodhimit (1/5 për Coliforme totale, për qumështin e pasterizuar , jo më shumë se 12/ml në 1 nga 5 mostrat e marra) (7).

Ndryshe paraqitet gjendja me produktet e marra në treg. Nga 45 mostrat e marra për analiza, 31 prej tyre rezultojnë të jenë me ngarkesë bakteriale mbi normat e lejuara. Kështu 61 % e mostrave të tregut kanë ngarkesë në Coliforme mbi normat dhe 39 % e mostrave kanë edhe E. Coli (9). Sic paraqitet edhe në pasqyrën e mëposhtme.

*Pasqyra 5. Tabela me të dhëna për çdo tregues mikrobiologjik për mostrat e marra në vendet e tregimit në % sipas treguesve mikrobiologjikë.*

<b>Treguesit mikrobiologjik</b>	<b>Nr.mostrave</b>	<b>% e mostrave</b>
Coliforme total	19	61
E.Coli	12	39
St.aureus	0	0
Salmonela	0	0
Shigela	0	0


Faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin mikrobial te produktet e gatshëm për konsum janë kushtet mjedisore të ruajtjes si temperatura (dhe koha e ruajtjes) (8) të cilat reflektohen në pasqyrat e mësipërme nr. 3 dhe 4. Mikroorganizmat, që mbeten në produkt pas përpunimit termik (pasterizimit), brenda një niveli të lejuar, nën ndikimin e temperaturës mbi + 4 °C, për një kohë më tepër se dy orë, zhvillohen dhe shumohen në mënyrë progressive (9).

Psh. bakteret me kohë dyfishimi 20 minuta, do të arrijnë deri në 16 000 000 pas 8 orësh qëndrimi në mjedis të përshtatshëm për rritje.

Siguria e produktit është e lidhur ngushtë me faktorët e jashtëm si psh në rastin tonë temperatura e ruajtjes, gjë e cila përforcohet edhe nga përpunimi statistikor i cili tregon që vlera p del £ 0.01. Kjo do të thotë se ekziston një lidhje sinjifikative midis temperaturës dhe sigurisë së produktit (4).

Influenca e kushteve të ruajtjes del indirekt edhe nga grafiku i mëposhtëm i cili paraqet numrin e mostrave të marra ne fabrika dhe treg me ngarkesë mbi normën e lejuar

Grafiku I . Paraqitja grafike e mostrave të marra në fabrika dhe treg me ngarkesë mbi normën e lejuar



### Konkluzion dhe Rekomandime

1.Nga sondazhi i kryer nxjerrim përfundim se kushtet e tregimit të produkteve ushqimore (bulmetra) nuk janë të përshtatshme për të garantuar sigurinë e produkteve për subjektet e marra në studim.

2. Rreth 69% e mostrave rezultojnë të ndotura mbi normat që përbën një rrezik potencial sidomos për fëmijët që janë konsumatorët kryesorë të këtij produkti

3.Nuk respektohet zinxhiri ftohës deri në shitjen te konsumatori. Të gjitha produktet e ndotura janë ato që janë marrë jashtë kushteve frigoriferike (10).

4.Formim i ulët tekniko-profesional i tregtuesve të këtij lloj produkti mbi rëndësinë e kushteve të ruajtjes (sidomos temperaturës).

5.Rekomandojmë në këtë rast rritje të informimit të publikut (tregetar dhe konsumator) për përzgjedhjen e vendeve të tregimit me kushtet e duhura higjieno-sanitare (11).

6.Nga konkluzionet e nxjerra nga ky sondazh rekomandojmë vazhdimin dhe zgjerimin e studimit për sigurinë ushqimore për bulmetrat si dhe për produktet e tjera dhe rritjen e sensibilizimit të konsumatorit nëpërmjet promocionit shëndetësor.

Bibliografia

**1.NCR.** An evaluation of public health hazards from microbiological contamination of foods. Publication No.1195. Natl. Acad. of Sciences, Natl. Res. Council, Washington, D. C. 1984.

**2.Codex Alimentarius,** Food Hygiene Joint FAO/WHO Food Standards Programme CODEX ALIMENTARIUS COMMISSION, (second edition) Rome, 2001; 10, 44 - 5

**3.Rregullorja Higjeno – sanitare** Nr 5 date 25/06/93 per marrjen e mostrave te produkteve ushqimore per analize laboratorike.

**4.Hughes J (2001).** *Principles of Biostatistics.* University of Washington, Seattle, USA

**5.Regolamento** recante attuazione delle direttive 92/46 e 92/47/CEE in materia di produzione e immissione sul mercato di latte e di prodotti a base di latte.

**6. Metodat e analizave** kimiko-toksikologjike dhe bakteriolgjike të produkteve ushqimore. Tirane 1985

**7. Jahannes Kramer, Carlo Cantoni,** “Alimenti –Microbiologia e Igiene” sec ed. OEMF spa, 1994; 308

**8.Ottogali G.** Microbiologia lattiero casearia. 1991

**9.** Normat mikrobiologjike te qumeshtit e nenproduteve. Ministria e Shendetesise 1985

**10. PieroRoccaro, Sebastiana Roccaro, Stefano Guernieri** “Sicurezza alimentare”2001; f 241-6

**11. Gazeta Ufficiale** n. 346 13 dicembre 1978

## “MONITORIMI I ZHURMAVE URBANE NE 8 QYTETE” PER VITIN 2006

### Qellimi i studimit:

- Te behet ne vazhdimesi nje monitorim i struktures se burimeve te zhurmave ne hapësire dhe ne kohe.
  - Pergatitja e nje harte kombetare te nivelit te Zhurmave.
  - Plotesimi i bazes se te dhenave per nje vazhdimesi monitorimi.
  - Identifikimi i kontigjenteve te popullates qe preken.
  - Pergatitja e bazes teknike per pergatitjen e nje studimi epidemiologjik.
  - Pergatitja e Bazes-Teknike per hartimin e projekt-Ligjit per disiplinimin e Zhurmave Urbane.
  - Afishimi i masave te parandalimit dhe te mbrojtjes.

### Përshkrimi i përgjithshëm i studimit

#### METODOLOGJIA

Matjet e zhurmave te urbane.

a. 1. Duke qene se trafiku rrugor eshte nje fenomen i karakterit te rastesishem ose pseudo te rastesishem, monitorimi i zhurmave te prodhuara prej tij u krye per nje kohe matje prej maksimalisht 5 dite. Ne nje periudhe te tille duhet te matet niveli i vazhduar ekuivalent i ponderuar LAeq, ne dy nenndarjet e 24 oreshit ate LAeq Dite dhe LAeq Nate.

Mikrofoni duhet te vendoset ne nje distance 1 m nga fasada e ekspozuar ndaj zhurmes me nivele me te larta dhe kuota nga toka duhet te jete deri 4 m. Ne mungese te godinave mikrofoni duhet te vendoset ne vendet perceptues sensibil. Vlerat duhet te krahasohen me nivelet maksimale te emisioneve te percaktuara ne rregulloren e ekzekutimit te parashikuar ne Tabelat Referuese.

2. Matjet duhet te behen ne mungese te ndryshimeve te rreshjeve, mjegulles dhe/ose bores; shpejtesia e eres nuk duhet te jete me e larte se 5 m/s.; mikrofoni duhet te jete i mbrojtur me kufje anti ere. Zinxhiri i matjeve duhet te jete ne perputhje me kushtet metrologjike te periudhes ne te cilen behen matjet dhe ne perputhje me normat e CEI 29-10 dhe EN 60804/1994. Niveli i zhurmave ambientale LA: eshte niveli i vazhduar ekuivalent i presionit akustik te ponderuar A<sup>0</sup>, te prodhuar nga te gjithë burimet e

zhurmave qe ekzistojne ne nje vend te caktuar dhe gjate nje kohe te caktuar. Zhurma ambientale perbehet nga bashkesia e zhurmave rrethepaqark si dhe nga ato te prodhuara nga burime specifike shqetesuese, me perjashtimin e ngjarjeve akustike te identifikuara te vecanta, me natyre te jashtezakonshme, krahasuar me vlerat ambientale te zones. Niveli qe perballtet me limitet maksimale te ekspozimit

a. Ne rastin e limiteve te diferencuara, referuar TM.

b. Ne rastin e limiteve absolute, referuar TR

Niveli i zhurmes limit: LR: eshte niveli i vazhduar ekuivalent i presionit akustik te ponderuar A0 qe perftohet kur perjashtojme burimin shqetesues specifik. Duhet te matet me menytrat identike te perdorura per matjen e zhurmave ambientale dhe nuk duhet te permbaje ngjarje akustike jo normale.

*Prania e zhurmave per kohe te kufizuar*: ekskluzivisht gjate kohes se referimit lidhur me periudhen ditore, merret ne konsiderate prania e zhurmave per kohe te kufizuar, ne rastin e vazhdimesise se zhurmes per nje kohe totale jo me te madhe se 1 ore. Ne kete rast koha parciale perfshin ne nje 1 ore vleren e zhurmes ambientale, e matur ne Leq (A), duhet te zvogelohet me 3 dB; ne rast se eshte me e vogel se 15 min Leq duhet te zvogelohet me 5 dB.

### Hyrja.

Objektivat e studimit:

Te behet ne vazhdimesi nje monitorim i struktures se burimeve te zhurmave ne hapësire dhe ne kohe.

Pergatitja e nje harte kombetare te nivelit te Zhurmave.

Plotesimi i bazes se te dhenave per nje vazhdimesi monitorimi.

Identifikimi i kontigjenteve te popullates qe preken.

Pergatitja e bazes teknike per pergatitjen e nje studimi epidemiologjik.

Pergatitja e Bazes-Teknike per hartimin e projekt-Ligjit per disiplinimine Zhurmave Urbane.

Afishimi i masave te parandalimit dhe te mbrojtjes.

Termt e References Akustika Urbane

- Monitorimi akustik urban
- Stacionet e monitorimit.
- Frekuenca e matjeve
- Kontrolli i cilesise se matjeve:
- Objektivat e monitorimit
- Buxheti i monitorimit akustik.

Tabela 1 : Vlerat treguese per zhurmen kolektive,ne mjedise te vecanta.

Mjedisi specifik	Efekti kritik ne shendet	LA <sub>eq</sub> (dBA)	Koha baze (ore)	LAm <sub>ax</sub>
Zona e jashteme banimi	<b>-Shqetesim serioz gjate dites dhe mbremjes.</b> -Shqetesim i moderuar gjate dites dhe mbremjes	55 50	16 16	- -
Ne brendesi te banesave	-Kuptueshmeri e fjaleve dhe shqetesime te lehta gjate dites dhe mbremjes	35	16	-
Ne brendesi te dhomes se fjetjes	-Prishja e gjumit naten	30	8	-
Nga ana e jashteme e dhomes se fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur	45	8	-
Klasa mesimi,kopshte femijesh (brenda)	Kuptueshmeri e fjaleve, veshtiresi ne shpjegim, komunikim, bashkebisedim	35	Gjate mesimit	-
Dhomat e fjetjes ne kopshte (brenda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	-
Ambjente pushimi (clodhje)	Bezdisje, shqetesim (burime te jashteme)	55	Koha e pushimit	-
Spitale,salla/ dhoma(brenda)	-Prishja e gjumit naten -Prishja e gjumit dite dhe ne mbremje	30 30	8 16	40
Spitale,salla trajtimi(brenda)	Interference (nderfutje) ne pushim, clodhje	# 1		
Zona industriale, tregtare,qarkullimi(mjedis i jashtem dhe i brendshem)	Humbje degjimi	70	24	110
Ceremoni,festivale,qendra argetimi	Humbje degjimi (klientet < 5 here/ vit)	100	4	110
Fjalime,ligjerata,manifestime te jashtme apo te brendshme	Humbje degjimi	85	1	110
Muzike dhe tinguj difuze ne kufjet e degjimit	Humbje degjimi	85 # 4	1	110
Impulsione zanore nga lodrat plasjet artific. e armet e zjarrit	- Humbje degjimit (te rriturit) -Humbje degjimit (femijet)			140#2 120#2
Parqet natyrore zonat e mbrojtura	Prishje e qetesise	#3		

# 1 = Sa me poshte (e ulet) qe te jete e mundur


# 2 = Presioni akustik maksimal (LAF, maximum) matur 100 hm larg veshit

# 3 = Zonat e jashteme qetesuese duhet te mbrohen dhe raporti i zhurmes me zhurmen baze duhet te ruhet sa me i ulet qe te jete e mundur.

# 4 = Poshte (nen) kufjet e degjimit, pershtatur me vlerat ne ambjent te hapur

Permbledhja e Monitorimit  
Qytetet e monitoruar me  
popullsitate perkatese jane:

	Qytet	Popullsia
1	Durrës	142511
2	Fier	80183
3	Korçë	79528
4	Sarandë	31032
5	Shkodër	104667
6	Tiranë	436016
7	Vlorë	103426
8	Elbasan	116466
	<b>Totali</b>	<b>1093829</b>



Popullsia e 8 qyteteve te perzgjedhura per monitorim perben mbi 30 % te popullsite te Shqiperise prej 3 401 198 banoresh (referuar INSTAT).

Ne po keto qytete, sipas te njejtir burim te dhenash, kane mbi 60% te automjeteve ne qarkullim.

Qellimi i ketij studimi eshte njohja e nivelit te ndotjes akustike ne pika te ndryshme te 8-te qyteteve te vendit, per te dhene mundesine qe te gjykohet mbi masen e ekspozimit te popullates ndaj zhurmave ne ditet e sotme, mbi ndertimin e banesave ne lidhje me rruget me trafik te madh dhe me qendrat industriale

#### **Perfundimet e arritura gjate monitorimit :**

Per studimin ne fjale  $LA_{eq} T$ , pra niveli mesatar ekuivalent i energjise se zhurmes ne filtrin A gjate perodes  $T$ ,  $LA_{eq} T$  qe perdoret per matjen e zhurmave te vazhdeshme, si zhurma e trafikut rrugor ose zhurmat industriale, pak a shume te vazhdeshme ne pikat e meposhteme te konsideruara ne nxehta dhe me nje perqendrim te konsiderueshem te popullates per vitin 2005 krahasuar me vitet 2002, 2003, 2004.2005

**Stacionet e monitorimit:****TIRANE**

Pikematja	Vlera Mes. Diten	Vlera Mes Naten
1. Skenderbeu	72 dB (A)	57 dB (A)
2. Partizani i Panjohur	71 dB (A)	55 dB (A)
3. Stacioni i Trenit	74dB (A)	54 dB (A)
4. Laprake	73 dB (A)	58 dB (A)
5. Kryq. 21 Dhjetori	74 dB (A)	65 dB (A)
6. Kryq. Vasil Shanto	74 dB (A)	63 dB (A)
7. Ish Blloku (B.A.)	70 dB (A)	62 dB (A)
8. Pall. Kongreseve	68 dB (A)	55 dB (A)
9. Rr Elbasanit	71 dB (A)	61 dB (A)
10. Kryq. Farmacia 10	73 dB (A)	60 dB (A)
11. Kryqezimi Drej.e Policise	69 dB (A)	54 dB (A)
12. Perballe sta. Dinamo	69 dB (A)	56 dB (A)
13. Perballe Shko se Bash.	72 dB (A)	57 dB (A)
14. Tek Shkolla 11 Janari	70 dB (A)	54 dB (A)
15. Kryqezimi tek Selvia	71 dB (A)	60 dB (A)

**DURRES**

Pikematja	Vlera Mes. Diten	Vlera Mes Naten
1. Hyrja në Durrës,	71 dB (A)	53 dB (A)
2. Përballë së Prefekturës	68 dB (A)	50dB (A)
3. Kryqëzimi i Portit	69 dB (A)	49 dB (A)
4. Drejtoria e Higjenes	70 dB (A)	48 dB (A)
5. Tek Spitali	67 dB (A)	46 dB (A)
6. Tek ish mapoja	69 dB (A)	45 dB (A)

**FIER**

Pikematja	Vlera Mes. Diten	Vlera Mes Naten
1. Kryqezimi i hyrjes	69 dB (A)	46 dB (A)
2. Perballe Perfektures	67 dB (A)	48 dB (A)
3. Kyqezmi i per Vlore	68 dB (A)	46 dB (A)
4. Perballe Bankes (Tregu)	67 dB (A)	43 dB (A)

**SHKODER**

Pikematja	Vlera Mes. Diten	Vlera Mes Naten
1. Kryqezimi ne hyrje	69 dB (A)	42 dB (A)
2. Perballe Universitetit	68 dB (A)	40 dB (A)
3. Perballe Xhamise	70 dB (A)	42 dB (A)
4. Tregu i shumices	71 dB (A)	40 dB (A)

**VLORE**

Pikematja	Vlera Mes. Diten	Vlera Mes Naten
1. Kryqezimi i Hyrjes	69 dB (A)	39 dB (A)
2. Tek Xhamia	71 dB (A)	41 dB (A)
3. Perballe Hotel Bolonja	70 dB (A)	43 dB (A)
4. Tek Uji i Ftohte	68 dB (A)	39 dB (A)

**SARANDE**

Pikematja	Vlera Mes. Diten	Vlera Mes Naten
1. Perballe Hotel Butrintit	71 dB (A)	38 dB (A)
2. Perballe Bashkise	69 dB (A)	39 dB (A)
3. Kryqezimi per Lagjen Koder	72 dB (A)	37 dB (A)
4. Tregu i Valutes	70 dB (A)	41 dB (A)



**KORÇE**

Pikematja	Vlera Mes. Diten	Vlera Mes Naten
1. Kryqezimi i Hyrjes	69 dB (A)	41 dB (A)
2. Tregu i Shumices	63 dB (A)	40 dB (A)
3. Tek Telekomit	68 dB (A)	39 dB (A)
4. Tek Spitali	64 dB (A)	37 dB (A)



**Elbasan**



Pikematja	Vlera Mes. Diten	Vlera Mes Naten
1. Kryqezimi (Fusha e Iparit)	70 dB (A)	42 dB (A)
2. Kryqezimi (perball stadiumit)	69 dB (A)	41 dB (A)
3. Kryqezimi i Rrugës Rinia .	67 dB (A)	37 dB (A)
4. Kryqezimi i Cerrikut.	71 dB (A)	40 dB (A)


Grafike krahasues per periudhat dite dhe nate midis qyteteve.



*Krabasimet per vlerat e dites (6 :00 – 23 :00) ne Vite 2002-2006*







III – KONKLUZIONE

Nese do te fillonim te zberthenim ne detaje dy grafiket e krahasimeve midis qyteteve ne periudha dite apo nate do te binin ne sy pa dyshim vlerat e larta te Laeq per dite ne te gjitha qytetet te cilat variojn ene kufijte e 70 dB (A), por perjashtuar tiranen e cila vazhdon te ruaj nivelet e saj te larta ne po ato vlera si ne vitet e shkuar por ndihet dukshem ngritja e Laeq ne qytete te tjere me nje ritje nga 2-3 dhe ne rastete vecanta si Korca dhe Saranda ne 5 dB(A).Per sa i perket periudhes se nates vihet re e njejta siuate ne tirane ku jeta e nates po vazhdon te konsolidohet ne vlera mjaft te larta 58-60 dB (A) me nje ndjekje te larget nga Durresi dhe Fierine kufijet e 50 dB (A) dukke vazhduar qetesisht ne qytete te tjere.

1. Ne te gjitha grafiket e mesiperem shihet qarte vlerat e perafeta pa pesuar ndonje renje te ndjeshme krahasuar me vitin paraardhes si pe kohen e dites dhe ate te nates, kontribut ky i nje fluksi me te madh te automjeteve qe u vu re nga specialistet qe kryen monitorimin. Ky fluks eshte rrjedhoje dhe e amullise se krijuar ne kryqezime si nga sasia e madhe e automjeteve dhe nga mos funksionimi i sinjalistikes me shumicen e njejeve.
2. Faktor tjetër me nje peshe shume te konsiderushme eshte levizja e mjeteve te renda mbi 10 Ton, prania e tyre ne nyje te tilla problematike veshitoreson shpejtesine e levizjes, manovrimin dhe rrit ne rreth 30 % nivelet e zhurmave.
3. Levizjet parazite jane nje tjetër faktor qe ndikon drejtperdrejt ne kontributin e zhurmave urbane.

4. Mungesa e theksuar e vendparkimeve te perkohshme apo te perhershme eshte nje tjetër faktor i cili ndikon ne rritjen e niveleve te ndotjes nga zhurmat.

5. Mungesa e rrugeve dytesore apo tretesore, te cilat do te ulnin ndjeshem perqendrimin ne akset kryesore sjell dhe mbingarkesen ne keto akse dhe rrjedhimisht rrit nivelin.

6. Gjendja motorrike e automjeteve ne qarkullim le shume per te deshruar, mosha e vjeter e tyre sjell uljen e parametrave optimale te certifikates teknike te automjetit, lidhur me emetimin e zhurmes.

Keto faktore dhe te tjere me me pak peshe ndikojne ne perfundimin se vendi yne tanime eshte nder vendet e para ne Europe me nje Ndotje Akustike Urbane ne keto parametra.

1. Nga tabelat e mesiperme shihet qarte ngritja e vlerave mesatare te ponderuara per secilen pike matje. Problematike po behet gjendja sidomos ne oret e nates, pra koha e gjumit.

2. Matjet u bene ne ore te ndryshme te dites per te qene perfaqesuese te minimumeve dhe maksimumeve te ekspozimit urban nga trafiku. Kemi shmangur cdo interference te zhurmave te nje natyre tjetere qe do te modifikonin nivelet e zhurmave te trafikut urban. Nivelet, jane gjithashtu perfaqesuese te te gjithë llojeve te makinave ne qarkullim (te renda apo te lehta) dhe me kapacitet minimal apo maksimal ne levizje.

3. Ne nje mase rreth +(3-5 %) vlerat e mbledhura kane rritje, pasi ne

rreth 70% te vlerave te perftuara, fluksi i automjeteve eshte rritur artificialisht, pasi qytetet perkatese kane pasur punime ne akse kryesore, devijime te detyruara te drejtimit te levizjes

### **Ne vazhdimesi**

Qellimi final i administrimit te zhurmave eshte perpunimi (percaktimi) i kriterave mbi bazen e te cilave do te krijohen limitet e normave te ekspozimit ne zhurme dhe te nxise vleresimin e zhurmave dhe luften kunder zhurmes si pjese perberese e programeve te shendetesise dhe mjedisit.

Keto objektiva baze duhet te udheheqin politikat nderkombetare dhe kombetare te kontrollit te zhurmave. Dokumenti Veprim 21 pershtatur nga Kombet e Bashkuara, permban nje numer principesh (parimesh) te kontrollit te mjedisit mbi te cilan mund te bazohen politikat qeverisese mbi administrimin e zhurmave : parimin e kujdesit, parimin “ndotesi-paguesi” dhe parandalimin e zhurmes. Ne te gjitha rastet, zhurma duhet te jete ne nivelin me te ulet te realizueshem per nje situatë te vecante. Kur shfaqet nje risk qe ve ne rrezik shendetin publik, duhen marre masa urgjente per mbrojtjen e shendetit publik, pa pritur qe provat shkencore te jene plotesisht te perfunduara. Kostot e marra nga ndotja nga zhurma (qe perfshijne survejancen, administrimin , reduktimin e niveleve dhe kontrollin) duhet te merren persiper nga pergjegjesit e burimeve te zhurmave. Masat per reduktimin e zhurmes ne burim, duhen marre sa

here qe kjo eshte e qarte se mund te realizohet. Eshte e nevojshme fusha juridike per administrimin e zhurmave. Normat kombetare te zhurmes mund te bazohen , zakonisht, ne direktivat nderkombetare, si per direktivat e tashme mbi zhurmat ne mjediset kolektive (bashkesi), ashtu edhe dokumentacioni kombetar mbi kriteret qe shprehin raportin doze-pergjigje per efektet e zhurmes mbi shendetin human. Normat kombetare mbajne parasysh faktoret teknologjike, sociale, ekonomike dhe politike specifike te vendit (shtetit zbatues). Duhet vene ne zbatim nje program me faza (etapa), mbi reduktimin e zhurmes, me qellim qe te merren nivele optimale te mbrojtjes sanitare afatgjate. Perberes te tjere te nje plani administrimi te zhurmes jane : survejanca e nivelit te zhurmave, kartografia e ekspozimit ne zhurme, modeli i ekspozimit, metodat e luftes kunder zhurmave (si reduktimi dhe masat mbrojtese) dhe vleresimi i zgjedhjeve te luftes.

Administrimi i zhurmes duhet:

Te filloje survejanca e ekspozimeve humane ne zhurme.

Te arrihet reduktimi i emisionit te zhurmes dhe jo thjesht burimet e zhurmes: per kete duhet patur parasysh:

mjedise specifike te tilla si : shkollat, mjediset e lojrave, banesat, spitalet. mjediset qe kane zhurma multiple, ose ku mund te perforcohen (shtohen) efektet e zhurmes.

periudha kohore te ndjeshme te tilla si mbremje, pushime, etj.

- grupe te riskuara si : femije apo personel me degjim te prekur (te demtuar) Te merren parasysh rrjedhojat e zhurmes ne planifikimin e sistemeve te

- transportit ose ne zenien e tokes.

- Perfshirja e sistemeve te survejances se efekteve ndotese nga zhurma.

- Vleresimi i efikasitetit te politikave te zhurmes ne reduktimin e efekteve ndotese dhe ekspozimin, dhe duke permiresuar pamjen (pejsazhin) zanor.

- Te pershtaten direktivat e tashme per zhurmat ne kolektiva ne objektiva te ndermjetme, ne rrugen e permiresimit te shendetit human.

- Pershtatja e masave mbrojtese per nje zhvillim jetegjate te mjedisese akustike.

## MBETURINAT DHE IMPAKTI NE SHENDET DHE MJEDIS

---

Dr. Arben Luzati  
Ing. Sanitar Bujar Reme

Problemet e gjenerimit te mbeturinave dhe te administrimit te tyre jane te shumta dhe te larmishme.

### **Qellimi:**

Te vleresohen problematikat e mbeturinave ne aspektin higjieno sanitar per te percaktuar shkallen e impaktit ne shendet.

### **Objektivi:**

- Te njihet gjendja e fushave te mbeturinave si dhe teknologjia e perpunimit te tyre.

- Te jepen rekomandime per zbatimin korrekt te rregullave higjieno sanitare ne fushat e depozitimit te mbeturinave

- Te krijohen partneritete te besueshme ndermjet pushtetit local komunitetit

Pirja e sotme e mbeturinave eshte ajo e prodhimit te materialeve inerte, duke patur parasysh intensitetin e madh qe ka marre fusha e ndertimit ne vendin tone. Por ne kete kuader nuk duhet te nenvleftesohen rreziqet qe lidhen me mbetjet e rrezikshme industriale, bujqesore etj. Politikat e minimizimit te mbeturinave mund te ruajne burimet dhe te ndihmojne per mbrojtjen e shendetit dhe mjedisit.

Çdo mase qe redukton konsumin global te burimeve eshte e dobishme per mjedisin dhe kontribuon ne nje menyre jetese me te dobishme.

Ndersa per vendet e Bashkimit European minimizimi i mbeturinave eshte nje ceshtje paresore, ne vendin tone grumbullimi dhe trajtimi i tyre eshte eshte nje nga sfidat me te rendesishme. Ndryshimi i situates do te kerkoje me shume kohe, perpjekje dhe investime. Fokusi kryesor i synimeve te hershme per kete sektor eshte zbatimi i nje sistemi te thjeshte por efikas.

Ne qender te ketyre planeve dhe strategjive duhet te jete pushteti vendor, i cili duhet te ndermarre iniciativa teknike, financiare dhe ndergjegjesuese per te permiresuar gjendjen ne kete sektor ne bashkepunim me institucionet perkatese dhe me komunitetin. Nje sistem modern grumbullimi dhe transporti i mire organizuar jo vetem mbron ne pergjithesi popullaten nga semundjet por eshte i sigurte dhe higjienik per kedo qe punon apo ka lidhje me kete sektor. Problemet e gjenerimit te mbeturinave dhe te administrimit te tyre jane te shumta dhe te larmishme.

Prirja e sotme e mbeturinave eshte ajo e prodhimit te materialeve inerte, duke patur parasysh intensitetin e madh qe ka marre fusha e ndertimit ne vendin tone. Por ne kete kuader nuk duhet te nenvleftesohen rreziqet qe lidhen me mbetjet e rrezikshme industriale, bujqesore etj. Per mbetjet urbane kerkohet nje organizim me i mire per grumbullimin, transportimin dhe asgjesimin e tyre. Me mbeturine kuptohet cfardolloj substance apo objekti, qe rrjedh nga aktiviteti human ose nga ciklet natyrale, e hedhur ose e destinuar per t'u hedhur. Ato permbajne ne pergjithesi prodhime te metabolizmit te njeriut, mbeturina te flores dhe te faunes, te karakterit ushqimor, vajrave, hidrokarbureve etj, qe nxjerr njeriu gjate aktivitetit te tij ditor . Gjithshka qe perdor njerezimi per plotesimin e nevojave te tij ne formen e produkteve ushqimore, qe

nxjerr industria apo kultivon bujqesia do te transformohet ne mbeturine.


(gaz, avuj, pluhura, mbeturina te ngurta, ne rrjedha ujore) Ne aspektin sanitaro –teknik mbeturinat bartin ne vetvehte tre probleme te rendesishme:

- Aksesin e kafsheve te vogla tek to;
- Inkubator per mikrobet, larvat dhe vezet e insekteve;
- Burim i demeve nga proceset e fermentimit;

Ndersa per Komunitetin European minimizimi i mbeturinave eshte nje ceshtje paresore, ne vendin tone grumbullimi dhe trajtimi i tyre eshte nje nga sfidat me te rendesishme. Nese do te bejme krahasime ne vlerat e mbeturinave te prodhuara ne qytete te ndryshme te Europes me ato te prodhuara ne disa nga qytetet tona veme re se ato jane nen mesataren e tyre si sasi , por administrimi i tyre eshte teper larg.

Sasia e mbeturinave urbane per fryme ne disa qytete europiane kg/fryme /vit

	<b>Mbeturina shtepiake</b>	<b>Mbeturina tregtare</b>	<b>Mbeturinat e lehta</b>	<b>Materiale te tjera</b>	<b>Totali</b>
<b>Berlini</b>	<b>386</b>	<b>209</b>	<b>21</b>	<b>32</b>	<b>648</b>
<b>Mynihu</b>	<b>373</b>	<b>204</b>	<b>14</b>	<b>67</b>	<b>658</b>
<b>Viena</b>	<b>305</b>	<b>122</b>	<b>2</b>	<b>42</b>	<b>471</b>
<b>Tirana</b>	<b>100</b>	<b>15.2</b>	<b>34</b>	<b>20.5</b>	<b>171</b>



*Mbeturinat ne qytetin e Tiranes*

Mbeturinat ne qytetin e Shkodres

Nr.	Ditet	Vegjetale	Letra	Tekstile	Plastmas	Metale	Gure	Xhama	Drure	Totali kg/dite
1	E pare	413	85	85	104	63	137	77	52	1016
2	E dyte	437	72	67	97	75	142	69	13	972
3	E trete	386	63	92	85	55	155	58	37	931
4	E katert	392	48	53	73	73	98	130	21	888
<b>Nr. 5</b>	<b>E peste</b>	<b>497</b>	<b>37</b>	<b>89</b>	<b>50</b>	<b>29</b>	<b>112</b>	<b>85</b>	<b>44</b>	<b>993</b>
6	E gjashte	516	157	67	188	68	78	88	28	1015
7	E shtate	448	125	72	106	82	87	124	86	1860
8	E totali javor	3300	536	495	687	444	824	648	229	6880
9	Mesatare ditore	425	98	45	89	63	32	51	10	813
10	E peste	443	74	71	97	63	116	89	37	989
11	E gjashte	298	79	69	97	80	38	54	25	740
12	E dyte	468	88	53	159	84	46	84	19	958
13	E totali javor	2966	708	423	843	434	194	286	146	5804
14	Mesatare ditore	420	79	60	64	75	78	111	26	913
15	E peste	421	100	60	116	62	28	41	19	847
16	E gjashte	563	52	37	115	23	122	83	35	1070
17	E shtate	621	92	64	124	56	48	82	18	1105
18	E totali javor	453	136	88	52	90	71	135	52	1077
19	Totali javor	3434	668	532	648	395	647	595	198	7117
20	Mesatare ditore	480	95	76	86	57	92	62	48	119
21	E dyte	538	119	102	105	134	358	65	61	1482
22	E trete	648	160	152	148	158	618	47	393	2324
23	E katert	762	178	226	157	181	423	75	129	2131
24	E peste	594	124	51	92	101	335	14	83	1394
25	E gjashte	538	88	82	59	112	385	11	139	1414
26	E shtate	515	56	70	55	78	300	17	55	1146
27	Totali javor	4158	791	754	678	812	2770	301	979	11243
28	Mesatare ditore	594	113	108	97	116	324	43	140	1606

Mbeturinat ne qytetin e Fierit

Mbeturinat ne qytetin e Durresit

Perpjekjet ne kete sektor jane ende te pamjaftueshme, per shkak te mungeses se fondeve. Privatizimi i ketij sherbimi ndonese ka kohe qe eshte kaluar perseri nivelii tij le per te desheruar. Ndryshimi i situates do te kerkoje me shume kohe, perpjekje dhe investime. Fokusi kryesor i synimeve te hershme per kete sektor eshte zbatimi i nje sistemi te thjeshte por efikas.

Situata aktuale kerkon vertet zgjidhje te problemeve emergjente si ne Shkoder, Tirane, Tropoje etj, por njekohesisht kerkohen zgjidhje te integruara dhe afatgjata.

Nga depozitimet e mbeturinave ne perroi e Shendrevices (Tropoje) jane

ndotur ujrat e ketij perroi, por njekohesisht edhe ujrat e lumit te Valbones, pasi ky perrua shkarkon ne kete rrjedhe ujore. Nga ana tjeter 30 banore qe jetojne ne kete zone, kane gene te shtruar ne spital me semundje infektive, per shkak te ekspozimit ndaj ndotjes se shkaktuar nga fusha e mbeturinave. Nder keto raste permenden edhe dy femije te cilet rezultojne me astme bronkiale, edhe si shkak i djegies se mbeturinave ne kete zone. Por rrezikshmeria dhe efektet direkte ne shendet jane verejtur edhe ne fushen e Sharres, ne Tirane, per te cilen po behen perpjekje per ta kthyer ne nje zone te administrimit te rregullt te mbeturinave

Temperatura letale dhe koha per shkaterrimin e patogeneve me te zakonshem te gjetur ne mbeturinat urbane

Patogenet	Semundjet	Temperatura letale ne °C	Koha ne minuta
<b>Mycrobacterium tuberculosis</b>	<b>Tuberkuloz</b>	66	15 – 20
<b>Corynbacterium diphteria</b>	<b>Difteri</b>	55	40 – 45
<b>Strptococcus pygenes</b>	<b>Septicemi</b>	54	6 - 10
<b>Brucella abortus</b>	<b>Ethe ondulante</b>	61	2- 3
<b>Salmonella typhi</b>	<b>Ethe tifoide</b>	60	25 – 30
<b>Salmonela schotmelleri</b>	<b>Gastroenterite</b>	60	15 – 20
<b>Treponema pallidium</b>	<b>Sifiliz</b>	50	25 – 30
<b>Entamoeba hystitica</b>	<b>Dizanteri amebike</b>	68	1 – 2
<b>Taenia saginata</b>	<b>Intestinae parazit</b>	71	4 – 5

Kostot e grumbullimit te mbeturinave mund te llogariten duke perfshire gjysmen apo edhe me shume, te buxhetit te pergjithshem te administrimit. Per rrjedhoje administrimi i mire eshte fitimprures nga ana ekonomike si edhe nga ana shendetsore dhe mjedisore.

Nje sistem eficient dhe i qarte i mbledhjes se mbeturinave eshte kryesor per mbrojtjen e shendetit te popullsisë. I gjithe plani i administrimit te mbeturinave per nje qytet apo rajon varet nga standartet e sherbimeve te grumbullimit. Nje sistem i avancuar grumbullimi dhe transporti i mireorganizuar, jo vetem mbron ne pergjithesi popullaten nga semundjet

por eshte edhe i sigurte dhe higjienik per kedo qe punon apo ka lidhje me kete sektor. Per te arritur rezultate pozitive gjate implementimit te veprimeve per administrimin e mbeturinave eshte e nevojshme qe te respektohen disa principe si:

- Kush ndot paguan
- Prioritet duhet te kete riciklimi i mbeturinave
- Autoritetet lokale te favorizojne trajtimin e mbeturinave sipas planeve lokale
- Prioritizimi i masave qe duhen marre per administrimin e mbeturinave duke mbajtur parasysh mbrojtjen e shendetit dhe te mjedisit

#### Bibliografia :

1. Luzati A. Teme studimore per mbrojtjen e titullit Doktor Shkencash, 1998
2. Maystre Y.L Dechets urbains, nature et caracterisation, EPFL, Lausanne, 1994
3. Manual ne ndihme te inspektoriatit sanitary shteteror, MSH, ISHP, Tirane,1998

## MATJET ANALITIKE TE NDRICIMIT NE SHKOLLAT E ARSIMIT 9-VJECAR DHE IMPAKTI NE SHENDET, NE GRUP-MOSHAT 6-9 vjec.

Arta AGO\*, Arti CICOLLI\*,  
Dr. Elizana PETRELA\*\*, Dr. Adrian HOXHA\*\*,  
Besnik SERJANI\*

### HYRJA

OBSH ka Objektiv Shendeti deri 2015: Promovimin e nje mjedisi te brendshem te pershtatshem... qe do te thote qe deri ne 2015 popullata europiane duhet te jetoje ne nje mjedis fizik me te sigurt, me nje ekspozim ndaj ndotesve te rrezikshem per shendetin, jo mbi standardet e pranuar ne nivel nderkombetar, dhe te kete mundesine e te jetuarit ne nje kuptim fizik e shoqeror te pershtatshem per shendetin: ne shtepi, ne shkollë, ne vendin e punes dhe mjediset publike ( 1 ).

Sipas te dhenave te OBSH-SE rezulton se popullata europiane kalon ne keto ambiente te brendeshme rreth 90% te kohes. Vecanerisht femijet kalojne deri ne 8 ore/dite, per rreth

200 dite/vit, ne mjediset parashkollore/shkollore (OMS). Keto te dhena theksojne rendesine e vecante qe merr ne kete menyre plotesimi i kushteve optimale i ketyre mjedisve per shendetin e femijeve, si vend kryesor ku ata kalojne pjesen me te madhe te dites.

Nga problemet me te rendesishme te Shendetit Publik jane edhe crregullimet pamore te femijeve kryesisht te moshes shkollore . Nga te dhenat e literatures theksohet se keto crregullime prekin rreth 5-10% te femijeve ( 2 ). Nga studimet e kryera nga specialistet e Klinikës Okulistike, ne Qendren Spitalore Universitare “NeneTereza” dhe Departamentit te Shendetit Publik, ne Fakultetin te Mjeksise, gjate viteve 1995-1996 ka rezultuar se 14.79 % e femijeve te klasave te para kane pasur probleme te pamjes ne nje ose ne te dy syte ( 3 ).

Para moshes 9-vjecare sistemi viziv i femijes eshte ende i pa zhvilluar mire dhe disa nga crregullimet e te parit mund te jene te kthyeshme, pra te jene te korrigjueshme. Prandaj ka shume rendesi kontrolli mjekesor i here pas hershem i ketyre femijeve me qellim parandalimin e hershem te crregullimeve. Ndersa per femijet e moshes mbi 9-vjec sistemi viziv eshte i zhvilluar dhe i maturuar plotesisht dhe mundesia e korrigjimit eshte me e pakët. Persa i perket identifikimit te ketij problemi ne keto grup moshë , nga ana teknike eshte plotesisht i realizueshem. Kjo ben te mundur nderhyrjen e menjehershme dhe ne kohen e duhur ( 4 ).

Rol te rendesishem ne identifikimin e hershem te faktoreve te riskut dhe trajtimin e tyre me nderhyrje te thjeshta, qe do te benin te mundur kufizimin e ecurise dhe perparimin e metejshem te problemeve te shikimit, *luan depistimi tek femijet e moshes shkollore*, kryesisht moshja 6-9 vjec (per arsyen e permendur me lart).

Nje vemendje e vecante ne institucionet shkollore duhet t'i kushtohet ndricimit natyror dhe artificial, i cili nese nuk eshte projektuar dhe vendosur ashtu sic duhet, sjell probleme ne sistemin pamor te femijeve.

Ndricimi natyror ne keto mjedise, varet nga nje sere faktoresh si:

- klime e drites se nje vendi me te cilen ne kuptojme faktoret si brezi geografik dhe kushtet meteorologjike;
- orientimi i shkolles dhe i dritareve;

- madhesia e dritareve dhe numri i tyre;

- sipërfaqja e dhomes, ngjyra e mureve te dhomes etj.

Procesi mesimor zhvillohet ne periudhen vjeshte-dimer-pranvere (duhen patur parasysh kushtet meteorologjike) si dhe, pothuajse ne te gjitha shkollat e vendit tone, procesi mesimor zhvillohet edhe pasditeve, prandaj lind nevoja e projektimit dhe vendosjes se nje sistemi ndricimi artificial ne parametra te tille qe te bejne te mundur zhvillimin normal te mesimit.

Ne projektimin e sistemit te ndricimit artificial duhen patur parasysh disa faktore si: niveli i ndricimit, forma

e ndricimit dhe shperndarja e mjeteve ndricuese, tipi i burimit dhe mirembajtja e tyre.

#### Qellimi

Studimi ka per qellim vleresimin higjienik te ndricimit natyror dhe artificial ne shkollat e arsimit 9-vjecar dhe matjen e mrehtesise se pamjes tek femijet e moshes 6-9 vjec, nepermjet realizimit te ketyre objektive:

- Ø Vleresimi higjienik i ndricimit natyror dhe artificial ne ambientet e brendshme te mesimit.

- Ø Matja e mprehtesise se pamjes **MP** (vizus) tek femijet e grup-moshes 6-9 vjec.

- Ø Vleresimi i shkalles se ndikimit te ketyre faktoreve ne lindjen dhe perparimin e crregullimeve pamore si dhe permiresimi i tyre per parandalimin e crregullimeve, qe ato shkaktojne ne kete grup-popullate.

#### Metodologjia

1. Ne kete studim cross- sectional u perfshine 506 femije te moshes 6-9 vjec, nxenes te 13 shkollave te arsimit 9-vjecar, te shtrira ne 5 rrethe te vendit:

- Tirane 3 shkolla (F. Noli, Dh.Leka, R. Jarani)

- Shkoder 2 shkolla (I. Qemali, P. Rrexhepi)

- Vlore 3 shkolla (J. Minga, 4-Heronjte, H. Mehilli)

- Korce 3 shkolla (S. Gura, Asdreni, Xh. Dishnica)

- Elbasan 2 shkolla (L. Gurakuqi, Q. Guranjaku )

Perzgjedhja e grupit target u be ne menyre rastesore, ndersa perzgjedhja e

shkollave u be duke patur parasysh kriteret:

- Te rikonstruktura
- Te reja
- Te parikonstruktura

2. U plotesua nje pyetesor, **pjesa e pare** e te cilit permban te dhena te pergjithshme socio- demografike te femijes; **pjesa e dyte** permban te dhena qe lejojne vleresimin e faktoreve, te cilet ndikojne ne ndricimin natyror dhe artificial te ambienteve te brendshme te mesimit; **pjesa e trete** permban te dhena mbi kontrollet periodike te femijes tek mjeku specialist (okulisti).

3. U krye matja e mprehtesise se pamjes te femijeve (*vizusit*) me ndihmen e nje table standard e si dhe

matja e ndricimit natyral dhe artificial ne baze te procedurave standarde te rekomanduara nga OBSH, me ndihmen e aparatit LUXMETER - "Testo 545".

Se fundi hedhja e gjithe te dhenave dhe perpunimi statistikor u realizua ne programet kompjuterike "SPSS-12" dhe "EXEL-2003".

Depistimi u krye sipas skemes se rekomanduara nga literatura ( 5, 2).


Rezultatet dhe diskutimi

Ne studim u perfshine 506 femije te grup moshes 6-9 vjec, nga te cilet 52.2% ishin meshkuj dhe 47.8% ishin femra.

Pas depistimit te vizusit rezultoi 19.6% e femijeve me mprehtesi pamje te ulur, shifer relativisht e larte.( Graf.I)


Graf.I. Frekuenca e femijeve me mprehtesi pamje te ulur.

Bazuar ne te dhenat e perftuara nga depistimi ne rrethe te ndryshme u vu re se Korca ka prevalencen me te larte te ketij crregullimi ( 31.7%). (Graf.II)




Graf.II. Frekuenca e femijeve me mprehtesi pamje te ulur, sipas rretheve.

Nga 99 femijet qe rezultuar me mprehtesi pamje te ulur, 87% e tyre nuk kane kryer asnjehere vizite kontrolli tek mjeku specialist (okulisti). Kjo perben nje arsye te rendesishme per diagnostikimin me vonese te crregullimeve pamore dhe mundesine e korrigjimit ne kohen e duhur.(Graf.III)




Graf.III. Frekuenca e femijeve me MP te ulet, te cilet nuk kane kryer vizite okulisti me pare (%).

Te dhenat tregojne se numri me i madh i femijeve me mprehtesi pamje te ulur u gjet aty ku koeficienti i ndricimit natyror eshte me i ulur (1: 8). Ben perjashtim rasti me koficient ndricimi 1: 5, ku ndodhen 8 femije me MP te ulet, i cili duket pak kontradiktor me sa u tha me lart por qe kjo mosperputhje ka te beje me faktin e ndikimit edhe te te komponentit te trashegimise ne crregullimet pamore.(Graf.IV )




Graf.IV. Frekuenca e femijeve me MP te ulet, e kerbasuar me koeficientin te ndricimit natyror

Bazuar edhe ne normat e rekomanduara nga Agjencia Nderkombetare e Ndrimit (700- 1000 lux) verejme se, 2 shkolla: “ J.Minga” (Vlore) dhe “L.Gurakuqi: (Elbasan) jane brenda normave te lejuara. Theksojme se te dyja keto shkolla jane te reja ose te ristrukturuar plotesisht (Graf.V).



Graf. V. Vlerat e ndricimit artificial ne 13 shkollat .

Lidhur me ndikimin e “llojit te burimit te ndricimit” 63.6 % e femijeve me mprehtesi pamje te ulur, mesojne ne ambiente me burim ndricimi inkandeshent (llampe e zakonshme elektrike),vetite e padeshirueshme te te cilit shkaktojne demtime te pamjes. , kundrejt 36.3% te tyre mesojne ne ambiente me burim ndricimi fluoreshent (Graf.VI).



Graf.VI. Frekuenca e femijeve me MP te ulet ne lidhje me burimin e ndricimit (%).

Ne tabelen e meposhtme paraqiten te dhenat mbi numrin e femijeve qe i jane drejtuar mjekut pas depistimit . Veme re se nga 99 femijet me mprehtesi pamje te ulur, vetem 33. % ( 33 femije) e tyre kane kryer viziten tek mjeku okulist, kjo per arsye subjektive te prinderve te femijeve. Nga 33 femijet e paraqitur tek mjeku okulist, 32 prej tyre ose 96.9 % paraqesin crregullime te te parit, te cilet kane filluar menjehere trajtimin mjekesor te tyre.

Lloji i vizites	Te semure	Normal	Totali
Depistim vizusi	99 (19.6%)	407 (80.4%)	506 (100%)
Vizite okulisti	32 (96.9)	1 (3.1%)	33(100%)

**Konkluzione dhe Rekomandime:**

- ▣ 19.6% e femijeve te perfshire ne studim rezultuan me mprehtesi pamje te ulur.
- ▣ 84.6% e shkollave ne studim rezultuan me ndricim te pamjaftueshem (nen normat e lejuara nderkombetare).
- ▣ Te parashikohen kushtet e ndricimit brenda normave te rekomanduara, qe ne projektimin e ketyre mjediseve me qellim parandalimin e patologjive, qe mund te shkaktohen.

▣ Te rritet roli i mjekut te familjes dhe atij te shkolles lidhur me ndergjegjesimin e prinderve per kontrollin periodik dhe te vazhdueshem te femijeve te tyre per problemet e shikimit.

▣ Eshte e domosdoshme qe normat tona orientuese , te perdorura deri me sot per ndricimin, te perafrohen me normat e rekomanduara nga Agjencia Nderkombetare e Ndricimit (Bazuar ne konceptet e reja, lidhur me fiziologjine e shikimit, ne funksion te ngarkeses se punes se nje nxenesi).

Bibliografia:

1. ROSANA LAVECCHIA E ELISABETTA TERRADURA"PROGETTO INDOOR"STUDIO SU COMFORT E INQUINANTI FISICI E CHIMICI NELLE SCUOLE
2. JEKEL J, ELMORE J, KATZ D. EPIDEMIOLOGY, BIOSTATISTICS AND PREVENTIVE MEDICINE, W.B.SAUNDERS COMPANY; 2000: 215-25.
3. HOXHA A, PETRELA E, DAJTI SH, GABRANI A, ZHUKA S, TONUZI A..CRREGULLIMET E PAMJES NE NXENESIT E KLASAVE TE PARA NE TIRANE. BULETINI I SHKENCAVE MJEKESORE. 2004;VELLIMI 35:106
4. SAROLLI Y, HOXHA A, GABRANI A, DAJTI SH, GJEBREA A.PARANDALIMI I CRREGULLIMEVE TE SHIKIMIT. TIRANE :SHTEPIA BOTUESE EXTRA; 2004 : 78
5. JEKEL J, ELMORE J, KATZ D. EPIDEMIOLOGY, BIOSTATISTICS AND PREVENTIVE MEDICINE, W.B.SAUNDERS COMPANY; 2000: 225-32.
6. WASSERMAN RC,CROFT CA, BROTHERTON SE. PRESCHOOL VISION SCREENING IN PEDIATRIC PRACTICE: A STUDY FROM THE PEDIATRIC RESEARCH IN OFFICE SETTINGS (PROS )NETWORK. PEDIATRICS 1992;89 (5PT):834-899(PUBLISHED ERRATUM IN PEDIATRICS 1992;90:1001).
7. PRESLAN M W,NOVAK A. BALTIMORE VISION SCREENING PROJECT.OPHTHALMOLOGY 1996;103:105-9.
8. AMERICAN ACADEMY OF PEDIATRICS COMMITTEE ON PRACTICE AND AMBULATORY MEDICINE, SECTION ON OPHTHALMOLOGY. VISION SCREENING GUIDELINES. PEDIATRICS 1996;98:153-7.
9. PETER BRODERICK, M.D PEDIATRIC VISION SCREENING FOR THE FAMILY PHYSICIAN.
10. BROWN MS.VISION SCREENING OF PRESCHOOL CHILDREN.CLIN PEDIATRIC 1975;14:968-73.
11. SIMONS K. PRESCHOOL VISION SCREENING:RATIONALE,METHODOLOGY AND OUTCOME.SURV.OPHTHALMOL 1996;41:3-30.

## SITUATA HIGJIENO-SANITARE E UJIT TE PIJSHEM NE ZONAT URBANE TE VENDIT PER PERIUDHEN JANAR – DHJETOR 2006

**Valbona Bara, Zaira Poga, Arben Luzati,  
Bujar Reme, Luljeta Leno, Alba Merdani,  
Ramazan Bukli, Kol Geraj, Alfred Shehi**

Furnizimi me uje te pijshem te sigurte si nga ana cilesore ashtu dhe sasimore perben nje kerkese te domosdoshme, qe per Ndermarrjet e Ujesjellesit eshte dhe duhet te jete nje nga prioritetet kryesore ne punen e tyre. Ndersa ne kendveshtrimin e shendetit publik, krahas problematikave te tjera, ujit te pijshem i kushtohet nje vemendje e vecante, per vete rendesine qe paraqet per kete fushe , cilesia dhe sasia e tij. Ne lidhje me kete, nder objektivat kryesore ne punen e specialisteve te shendetit publik eshte vleresimi i rrisqeve shendetesore lidhur me konsumin e ujit te pijshem higjienikisht jo te paster, gje qe sjell parandalimin e shperthimeve epidemike me origjine nga uji. Ne vendin tone problemi i furnizimit te popullates me uje te pijshem te mjaftueshem dhe me kualitet sipas normave higjienike, akoma perben nje problem per shendetin publik pasi

semundjet infektive qe perhapen me ane te ujit te pijshem sidomos ne kushtet e nje rrjeti ujesjelles dhe te kanalizimeve te amortizuar, perben nje problem serioz akoma prezent. Nga te dhënat e deritanishme të ardhura nga Inspektoriati Sanitar Shteteror i rretheve, vërehen se ka raste që në ujësjellësa sidomos në ato të fshatrave, nuk respektohen rregullat higjieno-sanitare të zonave të mbrojtjes së kaptazheve, ka dëmtime të rrjetit të ujësjellësave nga amortizimi i tyre, ose nuk kryhet disinfektimi i ujit, konform standarteve të përcaktuara. Në një pjesë të madhe të qyteteve vërehen të meta serioze në rrjetin shpërndarës të ujit të pijshëm. Ndonese perqindja e aksesit te popullsisë ne sistemin e ujesjellesit eshte e konsiderueshme, perseri furnizimi me uje te pijshem ne zonat urbane dhe rurale, pergjithesisht behet me orar te reduktuar, duke perjashtuar ketu disa qytete te cilet marrin uje pa nderprerje si Korca, Librazhdi, Policani, Selenica etj. Kohezgjatja mesatare e furnizimit me uje ne shkalle vendi, ne periudhen e veres luhatet nga 6 – 8 ore. Sistemet e ujesjelles-kanalizimeve demonstrojne aktualisht probleme te mirembajtjes te shoqeruara keto me demtime nga nderhyrjet pa kriter prej personave te ndryshem..Po ashtu në një numër të madh pusesh shtëpiake dhe burimesh lokale sidomos ne zonat rurale, nuk respektohen kërkesa të rëndësishme higjieno-sanitare. Kjo do te thote se struktura e investimeve duhet te orientohet edhe kah zonave rurale.


Organet e shendetit publik duke pare gjithë keto problematika te

situates higjiene-sanitare te ujit te pijshem ne vend, kontrollojne ne menyre te vazhdueshme, zbatimin e rregullave higjiene-sanitare per projektimin, ndertimin, rikonstruksionin dhe shfrytezimin e veprave tefurnizimit me uje te pijshem te percaktuara ne rregulloren higjiene-sanitare perkontrollin e cilesise te ujit te pijshem ne baze te VKM Nr. 145 date 26.02.1998 .Gjate vitit 2006 eshte kryer rishikimi i sistemit te monitorimit te ujit te pijshem .Aktualisht kontrolli i ujit te pijshem ne te gjithë zonat urbane kryhet ne 500 pika fikse te shperndara ne rrethin ujesjelles te cilat u shtuan me rishikimin e skemes se monitorimit te ujit te pijshem per zonat urbane.

Zgjedhja e pikave te kontrollit eshte realizuar ne bashkepunim me Inspektoriatin Sanitar Shteteror te rrethit dhe Ndermarrjeve te Ujesjellesit ne menyre te tille qe te japin nje tablo perfaqesuese te cilesise se ujit te shperndare ne te gjithë territorin qe mbulohet nga sherbimi i ujesjellesit. Numuri i pikave te kontrollit eshte vendosur ne baze te numurit te popullsise se cdo qyteti. Si ka rezultuar cilesia e ujit te pijshem ne vendin tone gjate periudhes Janar – Dhjetor 2006 Per vleresimin higjiene-sanitare te ujit te pijshem jane shfrytezuar te dhenat analitike mikrobiologjike ( treguesi E. Coli dhe nivelet e klorit ne uje ), te derguara ne Institutin e Shendetit Publik nga Drejtorite e Shendetit Publik ne rrethe.

Gjithashtu jane marre ne konsiderate inspektimet dhe ekspertizat te realizuara ne sistemet e ujesjellesave nga ana jone. Perpunimi i te dhenave per vleresimin mikrobiologjik eshte bere ne baze te rekomandimeve te OBSH-se per indikatorët e mjedisit (ujin e pijshem).


Nivelet e ndotjes mikrobiologjike ne ujin e pijshem ne qytetet e vendit paraqiten ne hartën e meposhteme:




Nga paraqitja e mesiperme rezulton se per vitin 2006 ndotjet me te larta ne rrjetin ujesjelles jane raportuar per ujesjellesat e Tropojes, Hasit, Lezhes, Kurbinit, Kavajes, Lushnjes, Fierit (gjashtemujori i pare i vitit). Ne ujesjellesin e Tepelenes dhe Memaliaj ne vazhdimesi gjate ketij viti eshte raportuar ndotje mikrobiologjike. Kjo gje eshte konstatuar dhe nga ana e jone gjate ekspertizave dhe analizave te tjera te kryera ne ISHP. Ndotje mikrobiologjike jane konstatuar dhe ne ujesjellesat e qyteteve Durres, Kukes, Diber, Burrel, Korce (Maliq), Mirdite, Kucove, Berat, Vlore, Gjirokaster dhe Sarande ndonese nivelet e ndotjes

mikrobiologjike kane qene ne nivele me te uleta se qytetet e permendura ne paragrafin e mesiperme. Gjithashtu duhet te permendim shtimin e rasteve me hepatit viral tipi A ne disa zona te Tiranës ne periudhen Qershor-Korrik 2006 ku shkaku kryesor ishte uji i pijshem, dhe mosklorinimi jo korrekt i tij. Duhet theksuar se per shendetin publik rendesi te madhe dhe te vecante kane dhe ndotjet e vogla te ujit te pijshem pasi keto mund te behen shkak i shperthimit te epidemive te medha.

Ne grafikun e meposhtem paraqiten nivelet e klorit ne rrjetin ujesjelles te zonave urbane te vendit te monitoruara gjate vitit.





**KONKLUZIONE**

Shtirirja e rrjetit te ujit te pijshem Situata e sherbimit te ujesjelles kanalizimeve ne Shqiperi paraqitet problematike duke patur parasysh rrjetin e vjeteruar, humbjet masive ne te gjitha pjeset e sistemit, lidhjet e paligjshme, furnizimin e paqendrueshem, mirembajtjen e kufizuar per shkak te mungeses se fondeve dhe levizjen e popullsise.

Pjesa me e madhe e sistemeve te furnizimit me uje jane te vjeter, me

tubacione metalike te korroduar dhe sigurojne shume pak ose aspak uje per konsumatoret.

Infrastruktura e ujit te pijshem siguron mbulim kryesisht dhe me shume ne zonat urbane.

Edhe pse pjesa me e madhe e popullsise merr furnizim me uje nga sisteme te centralizuara, cilesia e sherbimeve nga Ndermarrjet e Ujesjellesit mbetet akoma e ulet. Per shkak te faktoreve te shumte te mesiperm furnizimi me uje ne qytete

kryhet me orare te reduktuara , pra mungon aksesi ne sasi te ujit te pijshem. Ketu perjashtojme nje numer te paket qytetesh ku furnizimi me uje te pijshem eshte ne menyre te vazhdueshme gjate 24 oreve si qyteti i Korces, Librazhdit, Perrenjasi, Selenica dhe ne nje perqindje te konsiderueshme qyteti i Gramshit.

Shtrirja e rrjetit te kanalizimeve Sektori i sanitetit eshte me problematik se ai i ujit te pijshem. Mbulimi me sistem kanalizimesh ne zonat urbane eshte pothuajse i njejte me mbulimin me uje te pijshem, ndersa ne zonat rurale vetem nje pjese e vogel zonave te furnizuara me uje te pijshem eshte e pajisur me sisteme kanalizimi. Permiresimi i sistemeve te kanalizimeve nuk eshte bere ne vazhdimesi me zhvillimet e infrastruktures dhe materialet dhe teknologjia e perdorur nuk kane ecur perpara. Ne shumicen e rasteve, zonat urbane kane sisteme te kombinuara te ujrave te zeza se bashku me ujrata e reshjeve, te cilat perfundojne ne lumenj dhe det. Kanalizimet, te cilat ne pergjithesi kane plotesuar afatin e tyre te sherbimit si dhe jane amortizuar moralisht, jane te bllokuara ne shume vende duke shkaktuar derdhje jashte rrjetit dhe duke cuar ne kontaminimin e ujit te pijshem. Shume mbulesa pusetash mungojne dhe kjo ka cuar ne mbushjen e tyre me hedhurina.

Shumica e zonave rurale ka sisteme individuale kanalizimesh, kryesisht gropa septike te thjeshta pa tubacione shkarkimi. Vete fshataret jane pergjegjes per ndertimin e ketyre gropave dhe ata e bejne kete gjë pa

ndonje kriter teknik, pra, per kete arsye keqfunksionimi i tyre eshte i pritshem.

### **Kerkesa per uje te pijshem**

Zhvillimet e viteve te fundit ne vend kane sjelle shume ndryshime ne kerkesen per uje. Zonat urbane jane duke u zmadhuar shpejt dhe kane me shume nevoje per uje, nderkohe qe pjesa me e madhe e industrive – konsumatore te medhenj te ujit perpara 1990-s, nuk punojne me. Industrite dhe bizneset e reja jane duke u bere me aktive dhe kerkesa per uje jo vetem qe po rritet ne menyre te vazhdueshme, por edhe shperndarja e saj ne zona te ndryshme dhe koha e furnizimit ka ndryshuar.

Zhvillimi i turizmit ne zonat bregdetare kerkon kujdes me te madh per furnizimin me uje, vecanerisht ne vere kur kerkesa per uje eshte ne rritje. Nje shembull eshte Durresi ku uji eshte i disponueshme vetem nje here ne dy dite dhe jo me shume se dy ore.

Ne vendin tone ekzistojne probleme te shperndarjes se ujit dhe jo te prodhimit te tij. Per nga permbajtja e ujrave nentokesore, Shqiperia radhitet e dyta ne Europe pas Danimarkes.

### **Besueshmeria e furnizimit me uje**

Sistemet e furnizimit me uje te pijshem ne Shqiperi jane ne pergjithesi te thjeshte persa i perket ndertimit dhe operimit, kryesisht per shkak te cilesise se mire te ujrave natyrore te cilet nuk kane nevoje per trajtime te komplikuar. Sistemet e furnizimit marrin uje nga burimet natyrore, nga puset, ose nga kombinimi i tyre. Ne te

dy rastet i vetmi trajtim i parashikuar eshte klorinimi. Perjashtim ben Tirana ku nje teknologji me e avancuar pastron ujin e ardhur nga liqeni i Bovilles, i cili perdoret me pas per pirje. Sidoqofte, nisur nga urbanizimi i shpejte qe ka pesuar, Tirana ka me shume nevoje per permiresime te ngjashme per te optimizuar regjimin e furnizimit dhe te shperndarjes. Ka disa faktore qe shkaktojne defektet e furnizimit me uje : a) mirembajtja e pamjaftueshme; b) nderhyrjet e paligjshme; c) mbikonsumi dhe keqperdorimi; d) ne njefare mase cilesia e dobet e materialeve dhe e punes. Nga ky veshtrim i problematikes se sistemeve te ujesjelles kanalizimeve verejme se :

Ne sistemet e ujesjellesit verehen demtime te veprave te ujesjellesit si dhe te linjave te ujesjellesit per shkak te nivelit te amortizimit si dhe te nderhyrjeve te paligjshme ne to;

Humbjet e ujit ne rrjetin shperndares per kete arsye arrijne nivele te konsiderueshme, (per ujesjellesat e monitoruar mesatarisht ne rreth 43 – 47 %);

Furnizimi me uje te pijshem behet me orar te reduktuar, e cila sjell si pasoje infiltrimin e ujrave ne brendesi te tubacioneve te ujesjellesit

Nuk respektohen rregullat e zonave te mbrojtjes sanitare, duke rrezikuar cilesine e ujit te burimit te tilla raste mund te permendim ne ujesjellesin e Lacit, Vlores, Shkodres, Lushnjes etj dhe kjo me e theksuar ne ujesjellesat e zonave rurale te vendit.

Klorinimi i ujit ne shumicen e rasteve behet manual dhe ne menyre jo korrekte;

Sistemi i kanalizimeve te ujrave te perdorura eshte i amortizuar dhe shpesh bllokohet duke krijuar situata te renda, sidomos ne periudhen e veres.

#### REKOMANDIME

Problemet e mungeses se ujit te pijshem mund te lehtesohen mjaft nepermjet:

Gjetjes dhe reduktimit te rrjedhjeve Rikonstruksioneve te rrjetit ujsjelles, shkeputjes se lidhjeve te paligjshme dhe optimizimit te regjimit te depozitimit dhe shperndarjes se ujit.

Vendosja e sistemeve te pershtateshme te klorinimit dhe klorifikimi ne menyre te vazhdueshme nga ndermarrjet e ujesjellesit.

Rivendosja e zonave te mbrojtjes sanitare te burimeve ujore te ujesjellesave dhe respektimi i tyre.

*Bashkepunimi ndermjet Ndermarrjeve te Ujesjellesit, Pushtetit Lokal dhe specialisteve te Shendetit Publik ne nivel Qendror dhe atij Lokal perben bazen e funksionimit dhe te suksesit per te arritur nje akses te mire ne cilesi dhe ne sasi te uje te pijshem.*

## MONITORIMI I CILESISE SE AJRIT NE SHQIPERI GJATE VITIT 2006


A.Deliu – laboratori i monitorimit te ajrit

Rezultatet mesatare vjetore jepen ne tabelen 2 dhe grafikun 3 me poshte:

Tabela 2. Rezultatet mesatare vjetore te monitorimit te ajrit ne Shqiperi, viti 2006.

$\mu\text{g} / \text{m}^3$	LNP	PM10	SO <sub>2</sub>	NO <sub>2</sub>	Ozoni	Pb
<b>Tirana 1</b>	<b>249</b>	<b>116</b>	<b>22</b>	<b>30</b>	<b>102</b>	<b>0.3</b>
<b>Tirana 2</b>	<b>292</b>	<b>137</b>	<b>26</b>	<b>36</b>	<b>102</b>	<b>0.32</b>
<b>Tirana 3</b>	<b>171</b>	<b>84</b>	<b>18</b>	<b>23</b>	<b>106</b>	<b>0.24</b>
<b>Tirana 4</b>	<b>754</b>	<b>369</b>	<b>31</b>	<b>55</b>	<b>102</b>	<b>0.49</b>
<b>Tirana 5</b>	<b>224</b>	<b>108</b>	<b>22</b>	<b>27</b>	<b>104</b>	<b>0.26</b>
<b>Shkoder</b>	<b>213</b>	<b>100</b>	<b>18</b>	<b>21</b>	<b>103</b>	<b>0.28</b>
<b>Elbasan 1</b>	<b>179</b>	<b>79</b>	<b>19</b>	<b>21</b>	<b>100</b>	<b>0.27</b>
<b>Elbasan 2</b>	<b>235</b>	<b>117</b>	<b>28</b>	<b>28</b>	<b>102</b>	<b>0.32</b>
<b>Elbasan 3</b>	<b>159</b>	<b>73</b>	<b>18</b>	<b>18</b>	<b>101</b>	<b>0.22</b>
<b>Durres</b>	<b>201</b>	<b>93</b>	<b>19</b>	<b>24</b>	<b>106</b>	<b>0.28</b>
<b>Fier</b>	<b>219</b>	<b>106</b>	<b>24</b>	<b>25</b>	<b>105</b>	<b>0.29</b>
<b>Vlore</b>	<b>187</b>	<b>86</b>	<b>16</b>	<b>23</b>	<b>107</b>	<b>0.24</b>
<b>Korce</b>	<b>172</b>	<b>82</b>	<b>17</b>	<b>20</b>	<b>94</b>	<b>0.18</b>
<b>Mesatare si vend</b>	<b>250</b>	<b>119</b>	<b>21.4</b>	<b>27</b>	<b>103</b>	<b>0.28</b>
<b>Norma AL</b>	<b>140</b>	<b>70</b>	<b>60</b>	<b>60</b>	<b>120</b>	<b>1</b>
<b>Norma BE</b>	<b>70</b>	<b>40</b>	<b>50</b>	<b>40</b>	<b>110</b>	<b>0.5</b>
<b>Rekomand.</b>	<b>60</b>	<b>30</b>	<b>40</b>	<b>40</b>	<b>110</b>	<b>0.5</b>
<b>OBSH</b>						

Grafiku 3. Rezultatet mesatare vjetore te monitorimit te ajrit ne Shqiperi, viti 2006.



**Diskutimi i rezultateve**

Nga shqyrtimi i rezultateve te monitorimit te cilesise se ajrit, verehet:

1. Ne te gjitha pikat e matjeve tejkalohe normat e lejuara te vendit tone e ato te vendeve te BE lidhur me lenden e ngurte pezull (LNP) dhe lenden e ngurte me dimensione grimcash nen 10 mikron (PM10). Shkalla e tekjkalimit ne rang vendi (13 pika matje) eshte mesatarisht 79 perqind per LNP dhe 70 perqind per PM 10 referuar normave tona, dhe respektivisht 357 dhe 297 perqind referuar normave respektive te vendeve te BE.

2. Indekset e tjere jane brenda normave te lejuara, dhe vetem ne nje rast tejkalohe norma e vendeve te BE

lidhur me permbajtjen e dyoksidit te azotit NO<sub>2</sub> ne piken e 21 Dhjetorit te Tiranes.

3. Ne Elbasan ka ulje te permbajtjes se grimcave ne ajer ne te tre pikat e monitoruara. Kjo lidhet kryesisht me frenimin e aktivitetit per periudha kohe te konsiderueshme te ndotesve me te rendesishem industrial (KURUM çelik dhe fabrika e çimentos).Duke filluar nga data 19 nendor fabrika e çimentos punon me filtra të rinj të kapjes së shkarkimeve te pluhurit, gjë që është mjaft pozitive. Megjithate edhe pikat e Elbasanit jane perseri mbi normat e lejuara si permbajtje LNP dhe PM 10.


4. Tirana ka situatë të vazhdueshme grave, lidhur me përmbajtjen e grimcave të ngurta në ajrin e saj (shih tab. 4 dhe grafikun 5). Masat e marra deri më sot janë krejt të pa mjaftueshme për përmirsimin e cilësisë së ajrit urban në 'të. Përveç qarkullimit brenda saj të rreth 1/3 se numrit të përgjithshëm të makinave të

vendit, shpejtësia e lëvizjes është mjaft e ulët si rezultat i bllokimeve të zgjatura të trafikut nga punimet e ndërtimit të rregullimit të rrugëve. Çlirimet e ndotesve të ajrit në të tilla situata janë mjaft më të lartë se gjatë qarkullimit normal, me shpejtësi të lëvizjes. 30-40 km/ore.

**Tabela 4.** *Përmbajtjet e ndotesve kryesore të ajrit në tre pika të monitoruara të qytetit të Tiranës, periudha 2001-2006.*

$\mu\text{g} / \text{m}^3$	Viti	LNP	PM 10	NO <sub>2</sub>	O <sub>3</sub>
<b>Tirana 1</b>	2001	345	189	44	33
	2002	304	147	36	68
	2003	286	119	37	95
	2004	280	126	40	97
	2005	279	129	34	96
	2006	249	116	30	102
<b>Tirana 3</b>	2001	117	82	18	16
	2002	145	65	24	45
	2003	126	70	20	91
	2004	151	67	23	102
	2005	146	73	26	102
	2006	171	84	23	106
<b>Tirana 4</b>	2001	660	231	67	51
	2002	683	360	61	89
	2003	995	483	48	110
	2004	965	432	57	93
	2005	964	445	63	97
	2006	754	369	55	102
	<b>AL limit</b>	140	70	60	120
	<b>BE limit</b>	70	40	40	110

Grafiku 5. Permbajtjet e ndotesve kryesore te ajrit ne tre pika te monitoruara te qytetit të Tiranës, periudha 2001-2006.



**Përfundime**

Ekspertiza e OBSH, në raportin e vet të dt. 28 qershor 2006 lidhur me permbajtjen e grimcave te ngurta ne ajrin urban të Tiranës, shprehet si më poshtë:

1. Në se vleresimet e bëra në pjesë të tjera te Europës do të ekstrapolohen në Tiranë, humbja e pritëshme e jetë gjatesisë së popullatës së Tiranës për shkak të ndotjes së ajrit do të kapërcente 1.5-2 vite jetë.

2. Ky vlerësim krejtësisht teknik i situatës është pohim i gjendjes alert të cilësisë së ajrit në Tiranë para së gjithash, por edhe në qytete të tjere të vendit që kanë permbajtje të ngjashme grimcash në ajrin e tyre urban.

3. Rekomandojmë barazimin e vlerave tona limite për ndotësit kryesorë te ajrit urban me ato të vendeve te BE ( PM 10, SO<sub>2</sub>, NO<sub>2</sub> dhe ozon). Edhe pse jemi akoma larg për keq niveleve të lejuar sipas legjislacionit të BE për permbajtjen e grimcave të ngurta ne ajër (PM 10), ky lloj barazimi do te ndikonte mjaft në ndërgjegjësimin më të shpejtë të politik bërsave e të ekzekutivit lidhur me seriozitetin e situatës se ndotjes së ajrit urban në rang vendi, e do të fuqizonte veprime adekuate për përmirësimin e gjendjes.

